



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

Objekti: Shërbime Organizimi të Eventeve Sportive (CPV – 92622000-7)

Tabela e Përmbajtjes

Terma Reference për Organizim Eventiv Sportiv të organizuar nga "Ekipet Sportive në Shkollë"

"Procedura Prokurimi për Shërbime Multifunksionale të Organizimit dhe Menaxhimit të Eventeve Sportive në kuadër të projektit "Ekipet Sportive në Shkollë"".

Ref: Shërbime Rekreative Kulturore dhe Sportive

1. Rreth KOKSH	2
2. Rreth shërbimit të kërkuar.....	2
3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi.....	4
4. Metodologjia dhe plani i punës	3
5. Kualifikimet e nevojshme	3
6. Procesi i aplikimit	4
7. Dorëzimi i ofertave	5
8. Afati i Aplikimit.....	6
9. Procesi i Vlersimit.....	6
10. Informacion nëse është përdorur njoftim paraprak	6



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

1. Rreth KOKSH

KOKSH është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj.

KOKSH është pjesë e Lëvizjes Olimpike dhe angazhohet plotësisht të respektojë Kartën Olimpike dhe Kodin Antidoping të Lëvizjes Olimpike, si dhe të jetë konform me vendimet e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe legjislacionin e shtetit Shqiptar.

2. Objekti i shërbimit të kërkuar: Sherbime organizimi te ngjarjeve sportive dhe kulturore.

Për të përmbushur misionin e organizatës dhe për të shpërndarë frymën Olimpike më tej, KOKSH planifikon të organizojë evente sportive, trajnime, ndeshjet në bashki, ndeshjet në nivel qarku, dhe ndeshjet finale të përmbylljes së kampionatit sipas kalendarit të ndeshjeve dhe sipas nevojave për çdo event që do të organizohet.

Ftojme individët/kompanitë me aktivitet veprimtarie në shërbimin e kërkuar të Organizimit të eventeve dhe aktiviteteve sportive që janë të interesuar të bashkëpunojnë për të angazhuar në aktivitetet e KOKSH.

Nëpërmjet kësaj thirrje të hapur, KOKSH fton individët/kompanitë e interesuara të paraqesin ofertën e tyre sipas specifikimeve të mëposhtme.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi.

Nr	Emërtimi	Specifikim Teknik	Njësia	Sasia	Cmim pa Tvsh	Vler a	Burimi i Financimit	Kohezgjatja/Periodha
<i>a</i>	<i>b</i>	<i>c</i>	<i>d</i>	<i>l</i>	<i>2</i>	<i>3=1 x2</i>	<i>4</i>	<i>5</i>
1	Organizimi dhe menaxhimi i eventeve sportive në kuadër të projektit "Ekipet Sportive në Shkollë" (Volejbol, Basketboll, Ekipet Elite dhe Ekipet U10)	Shërbime multifunkionale të organizimit dhe menaxhimit të eventeve sportive, duke përfshirë koordinimin organizativ, mbështetjen logjistike dhe teknike, si dhe të gjitha shërbimet e nevojshme për realizimin e aktiviteteve sportive.	Cope	Rast pas rasti sipas kalendarit it Ndeshje, trajnime	leke/cope		Qeveria Shqiptare financim projekti "Ekipet Sportive ne Shkollë".	4 muaj ne te gjitha Qarqet sipas kalendarit te ndeshjeve,aktiviteteve dhe trajnimeve te miratuara nga "Ekipet Sportive ne Shkollë".

4. Metodologjia dhe plani i punës

Për realizimin me cilësi të këtij shërbimi, do të përzgjidhet operatori ekonomik që paraqet ofertën ekonomikisht më të favorshme, në përputhje me kërkesat teknike dhe financiare të përcaktuara në dokumentet e procedurës së prokurimit.

Metodologjia e zbatimit do të përfshijë:

- Identifikimin dhe përzgjedhjen e operatorit ekonomik përmes një procedure transparente dhe konkurruese, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik;
- Hartimin e një plani të detajuar organizativ dhe logjistik, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të projektit "**Ekipet Sportive në Shkollë**", bazuar në kalendarin e miratuar të aktiviteteve sportive;



KOMITETI OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR

- Organizimin dhe menaxhimin e eventeve sportive të volejbollit, basketbollit, si dhe aktiviteteve për ekipet elite dhe ekipet U10, duke garantuar koordinimin e të gjitha elementeve organizative dhe logjistike;
- Sigurimin e mbështetjes teknike dhe operacionale gjatë zhvillimit të eventeve, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor;
- Koordinimin e vazhdueshëm me organizatorët lokalë dhe strukturat përgjegjëse të projektit për garantimin e zhvillimit normal të aktiviteteve në të gjitha qarqet;
- Monitorimin e cilësisë së shërbimit gjatë gjithë periudhës së zbatimit, përmes komunikimit të vazhdueshëm me Autoritetin Kontraktor dhe verifikimit të përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Kohëzgjatja e këtij shërbimi është **4 muaj** dhe do të mbulojë organizimin dhe menaxhimin e eventeve sportive në të gjitha qarqet e vendit, sipas kalendarit zyrtar të aktiviteteve, ndeshjeve dhe eventeve të miratuara në kuadër të projektit **"Ekipet Sportive në Shkolla"**.

5. Kualifikimet e nevojshme

- Regjistrimi ligjor – Subjekti duhet të jetë i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe të ketë në objekt të veprimtarisë organizimin dhe menaxhimin e eventeve, organizimin e aktiviteteve sportive, shërbime logjistike ose veprimtari të ngjashme.
- Të paraqesë ofertën sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.
- Të disponojë kapacitetet organizative, teknike dhe logjistike të nevojshme për realizimin e eventeve sportive.
- Të ketë aftësi për organizimin dhe menaxhimin e aktiviteteve sportive në disa qarqe njëkohësisht, sipas kalendarit të miratuar nga projekti.

Për të qenë i përshtatshëm për këtë procedurë prokurimi, ofertuesi duhet të plotësojë këto kritere kualifikuese:

- Të ketë eksperiencë të mëparshme në organizimin dhe menaxhimin e eventeve sportive, kulturore ose aktiviteteve të ngjashme me pjesëmarrje masive.
- Të ketë kapacitet organizativ dhe logjistik për realizimin e eventeve sportive në përputhje me kërkesat e KOKSH dhe kalendarin e projektit **"Ekipet Sportive në Shkolla"**.
- Të paraqesë një ofertë të detajuar teknike dhe financiare, ku të pasqyrohen qartë mënyra e organizimit, metodologjia e zbatimit, afatet dhe kostoja e shërbimit.
- Të disponojë burimet njerëzore, pajisjet dhe kapacitetet teknike të nevojshme për organizimin, koordinimin dhe menaxhimin e eventeve sportive.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

- Të ketë aftësi për të ofruar mbështetje logjistike dhe operacionale gjatë gjithë periudhës së kontratës, duke garantuar zhvillimin normal të aktiviteteve në të gjitha qarqet ku do të zhvillohet projekti.
- Të sigurojë realizimin e shërbimit në përputhje me standardet e cilësisë, afatet e përcaktuara dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Procesi i aplikimit

Për të aplikuar në këtë thirrje kërkohet:

- Oferta Financiare per event.
- NIPT-in e biznesit
- Adresen e sakte dhe person kontakti.

6. Dorëzimi i ofertave

Për të aplikuar në këtë thirrje ju lutem dërgoni ofertat tuaja në zarf të mbyllur në emër të Sekretarit të Përgjithshëm të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar Z. Gerti Shima, në adresën:

Tirana Olympic Park

Rr. "Liman Kaba"

Tiranë, Shqipëri

P.O. Box 63

Email: secretary.general@nocalbania.org.al

7. Afati i Aplikimit

- Propozimet duhet të dorëzohen në adresën e mësipërme deri në datë 16.03.2026 jo më vonë se ora 16:00.
- Ofertat duhet të dorëzohen në gjuhën Shqipe.

8. Procesi i Vlerësimit

Vlerësimi do të kryhet sipas sistemit të pikezimit si më poshtë vijon:

Përshkrimi	Pesha në vlerësim %
Çmimi- Vlerësohet oferta më e favorshme ekonomikisht, bazuar në çmim	70%
Cilësia dhe kapaciteti – Vlerësohet shërbimi, si dhe aftësia e	30%



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

operatorit.	
-------------	--

9. Informacion nese eshte perdorur njoftim paraprak.

Nuk eshte perdorur njoftim paraprak ne lidhje me kete lloj sherbimi te kerkuar.